



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:155810
Datë: 04.06.2024
Numri i dokumentit: 05800665

Ac.nr.4277/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B. S., adresa fshati R. i R., të cilin me autorizim e përfaqëson H. K. avokat në Lipjan, kundër të paditurës Sh. S., adresa: fshati R. i R., të cilin me autorizim e përfaqëson A. H. avokat në Lipjan, objekti i kontestit keqpërdorim i të drejtave pronësore, vlera e objektit të kontestit 3500€, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.376/2017, datë 03.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit B.S. nga Lipjani, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan C.nr.376/2017, datë 03.03.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan me aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.376/2017, datë 03.03.2017, ka vendosur: I.REFUZOHET kërkesëpadia paditësit B.S. nga fshati R. I R., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Sh. S. nga fshati R. i R., që ti mbylle tri dritaret e hapura ne pjese përdhese dhe tri dritare te hapura ne pjesen e nenkulmit ne shtëpinë me etazhitet P+NK ne parcelën kadastrale nr. ...- ZK R. i R. te cilat janë të drejtuara nga paluajshmeria e paditësit B. S. nga fshati R. I R. si dhe te detyrohet I padituri ti kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore, si e PABAZUAR. II.OBLIGOHET paditësi B. S. nga fshati R. i R., që te paditurit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore ne shume prej 444.80, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit te këtij aktgjykimi nen kërcënimin e përmbarimit te dhunshme.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, për shkaqe të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën si të bazuar, dhe çështja të kthehet në rivendosje, apo të ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë dhe të aprovoj kërkesëpadinë.

E paditura ka ushtruar përgjigje në ankesë, përmes së cilës ka propozuar që të refuzohet ankesa, ndërsa aktgjykimi i goditur të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se:

- Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarës së tij, me datën 18.08.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurit, duke kërkuar të detyrohet i padituri Sh. S. që t'i mbyllë tri dritaret e hapura në pjesën përdhese dhe tri dritaret e hapura në pjesën e nën kulmit në shtëpinë e ndërtuar në ngastrën ../1 Z. K. R. i R. të cilat janë të drejtuara nga paluajtshmria e paditësit B. Sh.. Apo të detyrohet që dritaret e hapura në pjesën e përdhese dhe tri dritaret e hapura në pjesën e nënkulmit t'i mbyllë me blloka të xhamit. Si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Në arsyetimin e aktgjykimin të ankimit, gjykata e shkallës së parë ka paraqitur se gjykata me vrotim te drejtpërdrejtë ka konstatuar se objekti ndërtimor shtëpia e te paditurit është përdhese dhe një kateshe, e ndërtuar përreth ngastrës nr....-2 , ne katin përdhese ne pjesën perendimore ka tri dritare (kah ngastra nr....-2), ne katin e pare ne pjesën qe kufizohet me ngastrën nr....-2 ka dy dritare te cilat janë te vendosura ne një dhomë katin përdhese ka te hapura tri dritare, se për ndriçimin e këtyre dhomave - banjove, nuk ka mundësi te hapen dritare ne pjese tjera te objektit-shtëpisë, xhamat e këtyre dritareve janë te errësuar, ngastra nr....-2 gjendet ne pjesën perëndimore, ndërsa ngastra e te paditurit ku është ndërtuar objekti banesor-shtëpia gjendet ne pjesën lindore, e që te dyja kufizohen ne mes veti. Më tej ka arsyetuar se nga provat e administruara, duke përfshirë ekspertiza gjeodezike e hartuar nga ekspertja gjyqësore, vrotimi i drejtpërdrejtë i gjykatës me rastin e nxjerrjes se provës me ekspert gjyqësor te gjeodezisë, nga deklarata e dhen nga i padituri ne cilësi te palës, vërtetoi këtë gjendje faktike se i padituri ka ndërtuar shtëpinë P+1, ne ngastrën kadastrale nr...-1, e cila parcele ne ZKK ne L., ne regjistrat ku mbahet evidenca e palujtshmerive ne pronësi udhëhiqet ne emër te H. S. dhe H. S., ku ne katin përdhese ne pjesën qe kufizohet me parcelën nr.-2, e cila ne ZKK L. udhëhiqet ne emër te H. S., i ka te hapura tri dritare dhe ne katin e pare i ka te hapura dy dritare, dritare këto te cilat kane xhama te errësuar, nga te cilët nga

brenda dhomave ne te cilat janë vendosur dritaret me këta xhama, për ne oborrin ne ng. nr....-2 nuk mund te shifet, se për ndriçimin e dhomave se shtëpisë se te paditurit qe kufizohet me parcelën nr....-2, nuk ka mundësi te hapen dritare ne pjesën tjetër te shtëpisë për ndriçimin e këtyre dhomave, se shtëpinë i padituri P+1, e ka ndërtuar larg mexhes me parcelën nr....-2, ne një pjese 0...m, ne pjesën tjetër 0.56m, dhe ne pjesën tjetër 0...m, dhe se parcela nr....-1 dhe parcela ...-2, kufizohet njëra me tjetrën, se ne parcelën te cilën pretendon se është ne pronësi të paditësit nuk ka të ndërtuar objekt ndërtimore – shtëpi apo diçka tjetër.

Më tej gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se gjykata erdhi deri tek përfundimi se i padituri me hapjen e dritareve te shtëpisë me xhama te errësuar, nga te cilët nga brenda ne dhomat e shtëpisë se te paditurit nuk mund te shifet asgjë ne oborrin me ng. nr...-2, ne pjesën qe kufizohet me këtë oborr, nuk e ka cenuar kurrfarë privatësie te paditësit dhe nuk ka keqpërdorë kurrfar te drejte sendore qe është e ndaluar dhe ne këtë mënyrë kurrfarë demi material te përcaktuar me LMD-në nuk I ka shkaktuar paditësit, për çka edhe gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit si te pabazuar, si ne al. 1 te dispozitivit te këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të palës paditëse se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitivin i aktgjykimit është i qartë dhe për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë janë dhënë arsye. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Gjykata e shkallës së parë pasi kishte administruar provat, kishte arritur të vërtetoj gjendjen faktike për sa i përket fakteve se prona në të cilin i padituri ka ndërtuar shtëpinë dhe dritaret që përbëjnë objekt kontesti, janë të ndërtuara në parcelën ...-1, kurse parcela e paditësit gjendet në pjesë të ngastrës ...-1. Fakti se i padituri ka të ndërtuar shtëpi në ngastrën ...-1 nuk është kontestuar nga asnjëri nga ndërgjyqësit, po ashtu nuk është kontestuar se paditësi ka në zotërim fizik pjesë të ngastrës ...-0 nuk është kontestuar. Po ashtu gjykata e shkallës së parë ka administruar një kontratë të shitblerjes të datës 12.03.2009, nga e cila vërtetohet se paditësi kishte blerë pjesë të ngastrës. Nga ekspertiza e gjeodezisë gjykata ka vërtetuar faktin e ndërtimit të shtëpisë nga i padituri brenda parcelës kadastrale ...-1 dhe dimensionet e saj. Nuk është evidentuar se në parcelën që

paditësi ka në posedim ka të ndërtuar ndonjë shtëpi që i përket atij. Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata e shkallës së parë ka dalë në këqyrje në vend, nga e cila kishte vërtetuar se dritaret që janë të vendosura në katin e parë të shtëpisë së të paditurit, nuk ka mundësi të hapen në ndonjë pjesë tjetër të shtëpisë, kurse xhamat që janë të vendosur në katin për dhese janë të errësuar. Bazuar në ato prova që janë propozuar nga përfaqësuesit e ndërgjyqësve, gjykata e shkallës së parë ka paraqitur edhe arsyetimin, duke pasur parasysh, se kontesti i tillë udhëhiqet nga parimi se ndërgjyqësit janë ata që duhet të ofrojnë prova dhe propozime, me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike. Me mënyrën që gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundim për gjendjen faktike pajtohet edhe kjo gjykatë, ngase faktet që përbejnë aspektet kyçe të kontestit janë vërtetuar.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, gjykata e shkallës së parë ka arritur që të bëjë vlerësimin e saj në harmoni me të drejtën materiale. Nga analizimi i thënieve në ankesë, nuk është gjendur se cilat ishin ato prova që gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar në mënyrë të gabuar, në atë mënyrë që ka keqinterpretuar përmbajtjen e tyre, apo se nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, duke bërë të njohur për këtë gjykatë se një provë e caktuar do të dërgonte tek një gjendje tjetër faktike.

Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimin ankimor në mënyrën e elaboruar nga pala ankuese, për sa i përket aplikimit të së drejtës materiale, ndonëse për këtë gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, duke gjetur si pretendim të pa bazuar. Kjo gjykatë gjen se Ligji nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, në nenin 6 parasheh *“Keqpërdorimi i të drejtave sendore është i ndaluar. 2. Të drejtat sendore keqpërdoren, nëse përdoren ekskluzivisht ose qartas për t’i shkaktuar dëm personave të tjerë ose pasurive të tyre.”*

Me qëllim aplikimi të kësaj norme, sipas vlerësimit të gjendjes faktike të vërtetuar drejtë nga gjykata e shkallës së parë, nuk është gjetur se i padituri ka hapur dritaret me qëllim të keqpërdorimit të drejtave sendore, ky vlerësim vie nga fakti se gjykata e shkallës së parë kishte vërtetuar se dritaret e hapura në katin e parë të shtëpisë, nuk kishte mundësi tjetër të hapjes për qëllime të ndriçimit, kurse dritaret e katit për dhese ishin të errësuar. Vihet në dukje fakti se nuk është kundërshtar pretendimi si paditësi nuk jeton në ngastrën që pretendon se është penguar, dhe se pjesa e tij nga ngastra ...-0 (e cila në tërësinë e saj është më e madhe dhe në emër të N.. V.) është vetëm si arë, ashtu edhe është evidentuar nga eksperti gjeodet. Në këtë mënyrë pretendimi i paditësit se ai ndihet i penguar nga hapja e dritareve në shtëpinë e paditësit, nuk rezulton i bazuar për faktin se paditësi nuk jeton në atë ngastër, kurse në anën tjetër nga pozita që ka shtëpia e të paditurit, nuk mund të arrihet në përfundim se qëllimi i tij qartazi ka qenë keqpërdorimi dhe shkaktimi i dëmit paditësit. Po ashtu kjo gjykatë vlerëson të theksoj se vlerësimi i rrethanave në këtë rast kontestues është bazuar në gjendjen e tanishme të gjërave, ngase në qoftëse pala paditëse ndërton shtëpi në atë ngastër dhe veprimet që eventualisht mund të bëjë i padituri që do të cënonin shfrytëzimin e lirë të së drejtës së tij pronësore, mund të paraqes padi për të kërkuar mbrojtjen në një situatë të tillë.

Nga analizimi i rastit kontestues, duke përfshirë pozicionin e shtëpisë së ndërtuar nga i padituri dhe gjendjen e pronës të cilën e ka në posedim paditësi, nuk mund të vërehet se është bërë cenim i qartë apo pengim në përdorimin e pronës në shfrytëzim të paditësit. Për tu cilësuar se ka pasur pengim apo keqpërdorim do të duhej të bëhej i besueshëm ai pretendim. Për dritaret që janë hapur në katin e dytë të shtëpinë është vërtetuar se nuk ka pasur mundësi të hapeshin në pjesë tjera të shtëpisë, ndërsa ato të katin përdhes ishin të errësuar.

Për sa i përket pretendimit ankimor të paditësit se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka arritur në përfundim se paditësi i mungon legjitimiteti aktiv, lidhur me këtë gjykata vlerëson se vendimi i shkallës së parë fillimisht ka qenë orientuara në drejtim të vlerësimit të fakteve që i përkasin themelësisë së kërkesëpadisë së paditësit, në raport me vendimet e të paditurit, duke gjetur se nuk kishte keqpërdorim të të drejtave sendore, kurse në fund duke cekur se mungon legjitimiteti. Në vijim të këtij vlerësimi fakti se paditësi ka legjitimitet konfirmohet edhe nga kjo gjykatë, porse vendimi me të cilin është refuzuar kërkesëpadia është i drejtë, ngase po ashtu gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësime duke mos u kufizuar vetëm në mungese legjitimiteti të paditësit, porse edhe në çështjen se ndaj tij nuk ka pasur keqpërdorim të të drejtave sendore. Për aspekte që lidhen me të drejtën materiale, gjykata e shkallës së dytë kujdeset zyrtarisht dhe nëse vërehet se vendosja ishte e drejtë porse aplikimi jo i drejtë i normës materiale do të bëjë korrektimin përmes atij vendimi. Vlerësimi i rrethanave në drejtim të themelësisë apo jo të kërkesëpadisë së paditësit do të duhej të bëhej nga perspektiva nëse vërtet ka pasur keqpërdorim të të drejtave në dëm të tij, duke vlerësuar pra keqpërdorimin e posedimit, e jo nga fakti se atij i mungon legjitimiteti.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, porse nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
Ac.nr.4277/2021, datë 04.06.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli